

Nr.: 517
Data: 03.11.2023



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË

KE: 0390/ 320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/ 324 268
Web:

NUI: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 1402000001784638

DATA/DATE:	04.11.2023
PËR/TO:	Znj. Arbnesha Kuqi – Kryesuesen e Kuvendit Komunal
CC:	Arkivit
NGA/FROM:	N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë Mentor Hoxhaj – Kryeshef Ekzekutiv
TEMA/SUBJECT:	RAPORT VJETOR FINANCIAR VITIT 2022

E nderuar znj. Kuqi,

Ju lutem gjeni të bashkëlidhur raportin:

1. Raportin Vjetor Financiar (për vitin që përfundoi me 31.12.2022)

I cili është aprovuar me datë 07.03.2023

Me respekt!

Republika e Kosovës - Republika Kosova Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica Drejtoria për Punë të përgjithshme Administrative Uprava za Opšte, Administrativne Poslove			
Pranoj - Primljen Pranuar - Primljeno dt 03.11.2023			
Njësia organiz. Org. jedinica	Numri Broj	Shtojca Prilazi	Vlera Iznos
01-052/01-21209			

Gjakovë 2023



N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A. GJAKOVË

KE: 0390/ 320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/ 324 268
Web:

NUI: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 1402000001784638

Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica Gjakova Municipality
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË
Nr.: 121
Data: 10.03.2023

RAPORT VJETOR FINANCIAR

(Në pajtueshmëri me SNFR)
Për vitin që përfundoi me 31.12.2022

N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë
Adresa: Rr. Kole Lleshi p.n.- Gjakovë/Kosovë
Email: nplsagj@gmail.com, tel :383 (390) 324 268

Gjakovë, Shkurt 2023

N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë
NRB: 71228673, NUI 811444900

Indeks i shkurtesave të përdorura:

- **SNA** – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- **SNK** – Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitet
- **SNFR** – Standardet Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar
- **ATK** – Administrata Tatimore e Kosovës
- **TKPK**- Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
- **NPLSAGJ**- Stacioni i Autobusëve, Gjakovë
- **NUI**- Numri Unik Identifikues
- **NRB**- Numri i Biznesit
- **NPL** – Ndërmarrje Publike Lokale

Deklaratë e Pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë me 31.12.2022

Deklaroj se pasqyrat financiare për vitin raportues 2022 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë, sipas rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë nga aktivitete dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha parimet e kornizës së zbatueshme financiare dhe kërkesat e Ligjit 06/L- 032 për Kontabilitet , Raportim Financiar dhe Auditim .

Kryeshefi Ekzekutiv:

Mentor Hoxhaj

Zyra e Financave dhe Thesarit:

Natyra Rugova



	Shënim	2022 €	2021 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4.	31,116.92	5,562.00
Llogaritë e arkëtushme tregtare dhe të tjera	5.	88,314.45	80,748.00
Pasuritë e tjera afatshkurtra	6.	656.00	1,932.00
Gjithsej pasuritë afatshkurtra	totali	120,087.37	88,067.00
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7.	1,258,350.56	1,251,487.87
Pasurit tjera Afatgjate			
<u>Gjithsej pasuritë afatgjata</u>		<u>1,258,350.56</u>	<u>1,251,487.87</u>
Gjithsej pasuritë		1,378,437.93	1,339,554.87
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8.	915,203.68	895,126.03
Detyrimet e tjera afatshkurtra	10.	13,886.45	14,111.00
Gjithsej		929,090.13	909,237.03
EKUITETI			
Kapitali aksionar	9.	430,317.81	432,256.84
Fitimet e mbajtura			
Rezervat e tjera			
Fitimet nga Periudha		19,029.99	(1,939.00)
Gjithsej ekuiteti		449,347.80	430,317.81
Gjithsej Ekuiteti dhe Detyrimet		1,378,437.93	1,339,554.87

N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë
NRB: 71228673, NUI 811444900

	Shenimi	2022 €	2021 €
Të hyrat	11.	221,336.10	203,073.00
Kosotoja e shitjes			
Fitimi/ (humbja) bruto		221,336.10	203,073.00
Shpenzimet operative dhe administrative	12.	(37,236.82)	(32,099.00)
Shpenzimet e personelit	13	(160,024.00)	(172,341.00)
Shpenzimet e Zhvleresimit	7.	(995.53)	(572.00)
	Tot.	(-198,256.35)	(205,012.00)
Fitimi/ (humbja) operativ		23,079.75	(1,939.00)
Shpenzimet financiare		-	-
Fitimi/ (humbja) para tatimit		23,079.75	(1,939.00)
Shpenzimet e Taksave		(4,049.76)	
Fitimi/ (humbja) i/e vitit		19,029.99	(1,939.00)
Të ardhurat tjera gjithpërfshirese:	14.	-	-
Të ardhurat tjera gjithpërfshirese, grandi dhe subvencioni			
Të ardhurat tjera gjithpërfshirese të vitit		-	-
Gjithsej të ardhurat/ (humbjet) gjithpërfshirese të vitit		19,029.99	(1,939.00)

	Kapitali Aksionar	Fitimet e Mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja me 1 janar 2021	432,256.84			430,317.81
Fitimi/(humbja) i/ e vitit		(1,939.00)		
Difencat nga përkthimet				
Valutore				
Dividentat				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Shlyerja e aseteve të demtuara				
Gjendja me 31 dhjetor 2021	430,317.81			430,317.81
Gjendja me 1 janar 2022	430,317.81			430,317.81
Fitimi/(humbja), i / e vitit		19,029.99		
Diferencat nga përkthimet				
Valutore				
Dividentat				
Deponimet e kapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave				
Gjendja me 31 dhjetor 2022	430,317.81	19,029.99		449,347.90

	Shënimi	2022 €	2021 €
Rrjedha e parasë nga aktivitet operative			
Fitimi/ (humbja)/e vitit	9.	19,029.99	(1,943.00)
Rregullimet për zerat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvleresimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	7.	995.53	576.00
Shpenzimet e interesit			
Shpenzimet finaciare			
(Fitimi)/ humbja nga shitja e pronës, fabrikes dhe pajisjeve			
Shpenzimet e tatimit në fitim			
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja)/ zvogëlim në llogaritë e arkatushme tregtare dhe të Tjera	5.	(7,566.45)	7,066.00
Rritja / (zvogëlimi) i parapagimeve	6.	656.00	(175)
Ritja /(zvogëlimi) nv llogaritë e pagueshme tregtare dhe Tjera	8.	20,077.65	
(3,600.00)			
Rritja /(zvogëlimi)nv detyrime tjera	10.	(224.54)	(3,195.00)
Tatimi në fitim i paguar			
Interesi i paguar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitet operative (I)		32,968.18	(1,271.00)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për riparimet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7.	(7,413.26)	(2,474.00)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Invetuese (II)		(7,413.26)	(2,474.00)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Invetuese (III)		-	-
Rritja /(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalenteve të parasë (I+II+III)		25554.92	(3,745.00)
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim të vitit		5,562.00	9,307.00
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund të vitit	4.	31,116.92	5,562.00

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

1. INFORMATA TE PERGJITSHME

Ndërmarrja Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A. në Gjakovë është Shoqëri Aksionare, e konstituar me datë 05.11.2015 me numër të regjistrimit të biznesit: 71228673, numër fiskal: 601568233 si dhe numër të tvsh: 330311853 me adrese në Gjakovë, rruga "Kole Lleshi", PN.

Veprimtari kryesore e Biznesit është;

- i) Aktivitet shërbyese të rastit për transportin tokësor,
- ii) Aktivitet e tjera mbështetëse të transportit, dhe
- iii) Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t., transporti rrugor urban dhe ndër urban i pasagjerëve.

Biznesi posedon aktin juridik të themelimit (statutin), prej të cilit aksionar është Kuvendi Komunal – Gjakovë.

Biznesi i të punësuarve në ndërmarrje gjatë vitit 2022 ka qenë 42 punëtor. Në numrin e të punësuarve nuk është përfshirë Bordi i Drejtorëve.

DEKLARATA E QEVERISJES KORPORATIVE

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087), Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë është Ndërmarrje Publike Lokale e organizuar si Shoqëri Aksionare e cila përmes Bordit të Drejtorëve i përgjigjet Komisionit të aksionarëve përkatësisht Kuvendit Komunal në Gjakovë si aksionar 100% i vetëm i saj.

Sa i përket aspektit të rregullimit të të drejtave pronësore, NPLSAGJ bie në kuadrin ligjor të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr.02/L-123) dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Statutit i Ndërmarrjes të cilat janë aktet më të rëndësishme që e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes. Në bazë të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike nenit 3.2 dhe listës 2 të këtij ligji, NPLSAGJ kualifikohet si ndërmarrje publike lokale. Në bazë të këtij paragrafi, Komuna e Gjakovës zotëron 100 përqind të akisoneve të NPLSAGJ.

Kur një Komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit ushtrohen nga një Komision Komunal i aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Kuvendit Komunal dhe (ii) dy anëtare të tjere të emëruar nga votat e Anëtareve të

Kuvendit Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Komisioni i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Komisioni i Aksionarëve përzgjedh Bordin e Drejtorëve i cili përbëhet nga pesë (5) drejtorë. Katër (4) drejtorë zgjidhen me konkurs publik sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve. Drejtori tjetër është Kryeshefi Ekzekutiv i NPL-së i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NPL-së në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

Gjatë zgjedhjes drejtorëve, Komision Komunal i Aksionarëve duhet të sigurojnë që se paku dy (2) drejtor të zgjedhur të jenë ekspert, ose se paku të kenë njohuri adekuate të kontabilitetit, si kërkohet nga neni 17.4 i Ligjit për Ndërmarrje Publike.

Ndërmarrja udhëhiqet nga Menaxhmenti i cili përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtar i Financave dhe Thesarit, Keshilltari i Përgjithshëm/ Sekretari Korporativ dhe Zyrtar i Auditimit të Brendshëm, të cilët zgjidhen nga Bordi Drejtorëve. E që njëhere janë edhe zyrtare më të lartë në ndërmarrje në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Ndërmarrja Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë, si tërësi është e organizuar në dy njësi: 1. Njësia Ekzekutive dhe Administrative dhe 2. Njësia Operative

1. Njësia Ekzekutive dhe Administrative përfshirë: Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, Shërbimi Financiar, Shërbimi Juridik, Auditimi i Brendshëm, Prokurimi, kurse

2. Njësia Operative përfshinë: Njësia Udhëheqëse Afariste dhe Njësia Afariste Shërbyese.

1. Baza e Përgatitjes së pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmerisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF per NVM-të) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombtare të Kontabilitetit. Ato janë paraqitur në njësi monetare Euro.

b) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazen e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhëne në këmbim të të mirave dhe shërbimeve. Periudha raportuese e entitetit përfshinë një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 dhjetor të cdo viti. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë krahasuese duke paraqitur në këtë mënyrë saldot për vitin e tanishëm dhe të kaluar.

c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro që është edhe valuta funksionale e Ndërmarrjes.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje në SNRF-në për NMV, kërkon që Menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

e) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozites financiare dhe ajo e të ardhurave, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon që Ndërmarrja do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe të mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhes normale të biznesit.

2.Politika të rëndësishme kontabel

a) Njohja e të hyrave

Të hyrat nga shitja e peronizimit njihen në momentin e lëshimit të biletës së peronizimit, përkatësisht fatures, kurse të hyrat nga qirate njihen kur faturat janë dorëzuar. Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri të plotë.

b) Kosto e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

c) Tatimi

N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë pohuan tatimin në fitimin të realizuar për çdo periudhë financiare kontabel të kalkuluar në përputhshmëri me Ligjet në fuqi të aplikueshme për periudhën e caktuar, si dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimin dhe kontributet në të ardhura personale.

Ndërmarrja i nënshtrohet ligjit NR.06/L -105 për Tatimin në të ardhurat e Korporatave. Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe në tatimin e shtyer. Tatimi i pagueshëm aktual është bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit.

Tatimi i shtyer njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabel të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të

gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshem në të ardhmen dhe cdo humbje tatimore ose kreditimi tatimor të papërdorur. Pasuritë e shtyra tatimore maten me shumën më të lartë, në bazë të fitimit të tatueshëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar.

Vlera kontabel neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në cdo datë të raportimit dhe rregullohet për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimive të tatueshme në të ardhmen, çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

e) Përfitimet e puntorëve

N.P.L. Stacioni i Autobuseve SH.A., Gjakovë në rrjedhat normale të biznesit, bënë pagesat në emër të puntorëve për kontributet pënsionale dhe tatimet në të ardhurat personale të cilat janë të kaluar në bazë të pagave bruto sipas legjislacionit në fuqi. Këto shpenzime i ngarkohen pasqyrave të të ardhurave për periudhen e caktuar kohore.

f) Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (renia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjate jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

- Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore 5%
- Impiantet, makineritë 10%
- Pajisjet, inventari, kompjuteret 20%

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normen e zhvlerësimit, jeten e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie. Zhvlerësimi i pasurisë rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

g) Pasuritë e trupëzuara

Pasuritë e trupëzuara përcaktohen si softueri kompjuterik që njihet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë), amortizohen gjatë jetës së tyre të llogaritur prej 5 vitesh duke përdorur metodën lineare. Nëse ka një se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e amortizimit, jetës së dobishme ose vlerës së mbetur të një pasurie të paprekshme, amortizimi rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja. Ndërmarrja nuk ka pasuri të pa trupëzuara gjatë vitit raportues.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

a) Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në cdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatesisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperushme është e ulët, vlera kontabel ulët deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) me pas kthehet, vlera kontabel e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet për vlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikuperushëm (çmimin shitës minus kostot e shitjes, në rastin e stoqeve), parë jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do të ishte e njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë për pasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

b) Rreziku i normës së këmbimit

Transaksionet e valutes së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërmarrja nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontratat e të ardhmes të këmbimit gjatë vitit paraprak.

c) Llogaritë e arkëtushme tregtare dhe të tjera

Të hyrat nga shërbimet janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Të arkëtushme tregtare të shprehura në monedh të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperushme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

d) Detyrimet qarkulluese janë detyrimet ndaj palëve të cilat Menaxhmenti pret t'i përmbushë gjatë vitit të ardhmshëm fiskal. Detyrimet nga të ardhurat personale të muajit Maj 2020 për punëtorët e Ndërmarrjes për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020, sipas Vendimit të Bordit të Drejtorëve 368/23.10.2020 kanë mbetur 50% e të ardhurave personale në vlerë prej, 7,204.72 Euro. (Ky detyrim është shlyer në Janar të vitit 2023).

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve nr. 152 të datës 26.04.2021, është ndaluar së ekzekutuari pagesa e viteve të kaluara të punës (stazhit). Dhe kjo mbetet obligim për t'u shtyer në momentet kur ndërmarrja të këtë mundësi Financiare.

e) Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime nv bazë të afatave normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura nv monedhë të huaj shprehen në valuten Euro duker përdorur kursin e kembimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e kembimit valutor janë përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

f) Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpeznimet e interesit regjistrohen në bazë të metodvs sv interesit efektiv dhe jane përfshirë në shpenzimet financiare. Gjatë vitit 2022 Ndërmarrja nuk ka pasur kredi apo mbiterheqja si të ardhura dhe shpenzime financaire, jashtë të ardhurave dhe shpenzimeve operative.

g) Provizonet për detyrimet e garancisë

Ndërmarrja N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A., nuk ka provizione për detyrimet e garancise për vitin që perfundoi me 31 dhjetor 2022.

h) Aplikimi i standardeve ndërkombtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara. Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhen raportuese
Adoptimi i SNRF16 "Qiratë"

Në hartimin e pasqyrave financiare mirren parasysh të gjitha Rregullatoret dhe Standardet që janë në fuqi në lidhje me Qiratë.

Në vitin 2022, Ndermarrja ka pasur lokale të lëshuara me qira , 1 parking dhe 2 hapësira në garazhë për parkim të autobusëve apo kombibusëve, andaj janë aplikuar të gjitha elemente të SNRF.

5. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Arka	3,953.52	1,709.98
Banka	27,163.40	3,85.11
Gjithsej:	31,116.92	5,562.09

Paraqitja e parasë në fund të vitit 2022 sipas saldo gjendjes në arkë dhe bankë.

6. Llogaritë e arkëtushme tregtare

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Të arkëtueshme tregtare	88,314.45	80,748.05
Provizion i të arkëtueshmeve		
Gjithsej:	88,314.45	80,748.05

Duke mos raportuar të arkëtueshmet sipas vjetërsisë në mungesë të dokumenteve kronologjike që nga koha e pasluftes, është shumë e vështirë të bëhet një vlersim mbi performancën e ndërmarrjes, për të pasur një pasqyrë të qartë së çfare ka ndodhur me borgjet paraprake.

Ne vitin 2022 kemi trashëguar borgje të arkëtushme në vlerën prej **80,748.05 euro**. Vetëm në vitin 2019-2020 janë raportuar borgje në shumën prej 19,625.6 euro.

Gjate viti 2022 kemi arritur të inkasojmë vetëm 3,103.80 nga llogaritë e arkëtushme të viteve 2019-2021. Pjesa e mbetur e llogarive të arkëtueshme 12,826.7 euro edhe pse ekziston dokumentacioni dhe rastet e fituara në gjykatë (në disa prej tyre) është mjaftë sfiduese për tu inkasuar. Gjersa borxhi i ministrisë së transportit në shumën prej 3,887.1 euro i raportuar si llogari e arkëtueshme, nuk ka baze të mjaftueshme, ngase mungon kontrata e shfrytëzimit për kohën e faturimit.

Prej shumës totale të llogarive të arkëtushme 61,122.45 janë borxhe të trashëguara ndër vite, për të cilat për shkak të vjetërsisë konsiderojmë që janë mjaftë sfiduese të arkëtueshme.

Nga kjo mund të konkludohet se, shuma e llogarive të arkëtushme nuk paraqet vlerën e saktë të kërkesave ndaj klienteve dhe vlera është shumë e mbivlerësuar dhe ndikon në keq informimin e përdoruesve të pasqyrave të tyre financiare.

7. Pasuritë tjera afatshkurtra

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Pasuritë tjera afatshkurtra	656.00	1,757.00
Gjithsej:	656.00	1,757.00

Pasuritë tjera afatshkurtra paraqiten saldo parapagimet ndaj tatimit në fitim në fund të vitit 2021.

8. Prona, Impiantet dhe pajisjet

	Toka	Ndertesat	Inventari	Gjithsej:
Gjendja më 01.2022	924,987.45	332,574.11	9,197.79	1,266,759.35
Riparimet	-	3,247.46	4,165.80	7,413.26
Shpenzimet e Zhvlerësimit		162.37	833.16	(995.53)
Gjithsej gjendja më 31.12.2022	924,987.45	319,030.50	10,627.38	1,258,350.56

N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë

NRB: 71228673, NUI 811444900

Gjatë vitit 2022, me procedura të prokurimit publik janë kryer investime në N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë në vlerë prej **7,413.26** Euro duke u kapitalizuar si vlerë dhe duke rritur vlerën ndërteses.

9.- Llogaritë e pagueshme tregtare

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Të pagueshmet tregtare:	-	895,126.03
1. ATK	727,330.69	
2.KOMUNA GARAZHDA	32,498.88	
3.KOMUNA	144,398.88	
4.NGROHTORJA E QYTETIT	10,975.23	
Gjithsej:	915,203.68	895,126.03

Që nga data 30.05.2012 me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike 03/L-087 të publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.13, është vendosur që Stacionet e Autobusëve të Komunave të jenë në pronësi të tyre, kështu që në bazë të këtij Ligji, Stacioni i Autobusëve në Gjakovë ka kaluar në pronësi të Komunës së Gjakovës 100%.

Me datë 05.11.2015, Stacioni i Autobusëve u regjistrua pranë ARBK si Shoqëri Aksionare, ku aksionar i 100% të aksioneve të saj është Komuna e Gjakovës. me numër të regjistrimit të biznesit: 71228673 numer unik: 811444900, numër fiskal: 601568233 si dhe numër të tvsh: 330311853 me adrese në Gjakovë, rruga "Kolë Lleshi", PN

Stacioni i Autobusëve si trashëgimtare e Kosova Trans ka trashëguar dhe borgjin prej ndaj ATK-se i cili i patrajtuar ndër vite ka arritur shumën prej **727,330.69**.

Llogaritë e pagueshme gjatë vitit 2023 përfshijnë edhe detyrimet e trashëguara ndaj Tatimit të paluejtshmërisë në vlerë prej **176,897.76** euro si dhe detyrimi ndaj 'Ngrohtores së Qytetit në vlerë prej **10,975.23** euro.

NPL Stacioni i Autobusëve ka mbajtur disa takime përfaqësues të ATK-së dhe me Aksionarin me të cilët është biseduar dhe është trajtuar mënyra dhe mundësia e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së. Gjithashtu kemi mbajtur takim me zyrtar për Tatimin ne Prone pran komunës se Gjakovës, ku kemi vërejtje tona sa i përket tatimit qe do e adresojmë ne momentin e pranimit te faktures,

10. Detyrimet Tjera Afatshkurtra

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Tatimet në pagë dhe kontribute 12/2022	1,335.74	1,495.37
Tvsh e pagushme 12/2022	3,386.00	2,824.33
Të ardhurat personale 05/2020	7,204.72	7,204.72
Zotim i mjeteve -	1960.00	
Stazhi për ish punëtorët	(-) 1	2,586.46
Gjithsej:	13,886.45	14,110.88

Te ardhurat perosonale te puntoreve ne shumen prej 7,204.72 euro, te bartun nga viti 2020, eshte paguar ne Janar te vitit 2023. Ne nkemi bartur pjese e shpenzimeve afatshkurtera per te ardhur personale, gjersa jemi duke u konsultuar me bazen ligjore sa i perket detyrimit per pagese ne obligimeve sa i perket stazhit te puntoreve.

11. Ekuiteti

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Kapitali	430,317.81	432,256.84
Fitimet e mbajtura	19,029.99	
Humbja e vitit vijues	-	(1,939.00)
Gjithsej:	449,347.90	430,317.81

Fitimi i mbajtur per vitin 2022 është në vlerën prej 19,029.99 euro.

12. Të hyrat nga Shërbimet

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Të hyrat nga peronizimi	127,468.97	121,091.15
Të hyrat nga qiratë	74,603.59	72,749.00
Të hyrat nga kompenzimet e qiramarr.	9,066.09	8,913.40
Të hyrat nga Subvencioni i Qeverisë	-	-
Të hyrat tjera	10,197.45	319.45
Gjithsej te Hyra:	221,336.10	203,073.00

Të hyrat nga peronizimi janë rritur gjatë vitit 2022 në vlerë prej 6,781.07 Euro. Të hyrat nga qiratë në vitin 2022 janë rritur në vlere prej 1,854.06 euro pas harmonizimit të çmimeve të lokaleve. Të hyrat nga kompenzimet e qiramarrësve (rryma, uji dhe mbeturinat) në vitin 2022 janë rritur prej 152.69 euro krahasuar me vitin 2021. Të hyra nga Subvencioni gjatë vitit 2022 nuk ka pasur. Të hyrat tjera përfshijnë të hyrat nga veturat gjate vitit 2022 jane 10,197.45 nga parkingu.

13. Shpenzimet Operative

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Mallra dhe shërbime	14,559.34	17,720.00
Shërbimet Publike	15,264.22	14,379.00
Kapitale	7,413.26	
Gjithsej:	37,236.82	32,099.00

Vlera totale e shpenzimeve tejkalon shumën prej 5,137.82 Euro me shumë se vitin paraprak. Kjo për shkak të investimeve kapitale në vlerën prej 7,413.26, si dhe intervenimeve dhe investimeve në mirëmbajtjen dhe rregullimin e hapësirave të NPL Stacionit të Autobusëve të Gjakovës.

14. Investimet Kapitale

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Arkë fiskale lëvizëse – portative	298.80 €	
Karrika pune	932.00 €	
Kondicionerë	985.00 €	
Shtruarja e dyshemesë (laminat)	857.46 €	
TV dhe pajisje TI-se për procesin e digjitalizimit	1950.00 €	
Fasada strukturale dhe sinjalizimi	1980.00 €	
Gjithsej:	7,413.26 €	0.00

NPL Stacioni i Autobusëve ka trashëguar një objekt dhe inventar të vjetër me decenie pa mirëmbajtjen e duhur dhe pa investime të domosdoshme.

Gjatë vitit 2022 janë bërë investime në rritjen e kontrolles së brendshme, përmirësimin e kushteve të punës, informimit dhe arritjes së standardeve të parapara me legjislacionin në fuqi.

15. Shpenzimet e personelit

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Pagat Bruto	161,024.00	172,341.00
Gjithsej:	161,024.00	172,341.00

Shpenzimet në paga janë 12,188.00 euro më pakë se në vitin paraprak, apo 7.07% më pakë. Pavarësisht shpenzimet në paga përbën 79% të tërë buxhetit, vlerë kjo mjaft e lartë që len hapësirë të kufizuar për investimet e domosdoshme. Duke rikujtuar se NPL Stacioni i

Autobusëve operon 24/7 ne dy hapësira, qe ne vete ngërthen obligime te angazhimit te një numri te madhe te personelit.

16. Ndikimi i COVID-19

Që nga përhapja e pandemie COVID-19, N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A Gjakovë monitoron nga afër zhvillimin e situates në nivelin lokal, evropian dhe global. Ndërmarrja zbaton me përpikëri masat e propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Institucionet e saj përkatëse. Gjithashtu, si Ndërmarrje Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë, ka qenë e vemendshme në masat shtesë parandaluese, për të mbrojtur punonjësit e saj, furnitoret dhe proceset e vazhdueshme rrjedhës të biznesit. Duke pasur parasyh dinamiken e përhapjes së kësaj pandemie, dhe natyres monetare të trajnimit si dhe në format që janë ndërmarre nga Autoritet për të parandaluar dhe menaxhuar atë, ne presim që megjithate të mos ketë ndikim në rezultatet e Ndërmarrjes. Megjithatë, aktualisht në datën e raportimit të këtyre pasqyrave është e pamundur të vlerësohet ndikimi i pandemie COVID-19, në vlere financiare për muajt dhe vitet në vijim.

N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A., Gjakovë
NRB: 71228673, NUI 811444900

Shënim Përmbledhës: RAPORT VJETOR FINANCIAR i hartuar ne pajtim me SNRF i NPL Stacioni i Autobusëve Gjakove, pasqyron ne mënyrë të saktë dhe transparente të dhënat financiare të kërkuar me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin ne fuqi, dhe si i tillë është aprovuar ne mënyre unanimitet.

Miraturar me datën 07.03.2022

Mentor Sylmeta


Kryesuesi i BD të NPL SA Gjakovë

